

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

4.06.2024

Ora, 10:59

RENDI I DITËS

“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 6, datë 22.5.2024, të depozituar nga subjekti “Partia Ardhmëria Shqiptare”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. I. Rusmali,
z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. J. Josifi, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** PSSH (znj. Sh. Ballhysa, znj. Dh. Isufaj)
BD (z. F. Topollari)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. K. Bele: Çelim seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 6, depozituar në datën 22.05.2024. Subjekti ankues Partia Ardhmëria Shqiptare, përfaqësuar nga kryetari Emin Subashi. Ankimi ka si objekt kundërshtimin e vendimit nr. 38, datë 9.04.2024 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vendim i cili ndëshkon partitë politike. Verifikojmë prezencën! Është prezent trupa e KAS-i me të pestë anëtarët. Është prezent administrata e KQZ-së si dhe për subjektin ankues, relatohet që ka marrë dijeni, por nuk është prezent. Në këto kushte ne vazhdojmë seancën pavarësisht nga mungesa e subjektit. Ju lutem qëndrimi i KQZ-së në lidhje me kërkimin, shumë shkurt, faleminderit!

Znj. M. Koja: Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve! I nderuar zoti relator! Sikundër dhe ju relatuat më lart, ndaj vendimit të KSHZ nr. 38,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

të vitit 2024 “Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i raporteve financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022”, është depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesa ankimore nr. 6, me datë 22.05.2024, me kërkues Partia Ardhëria Shqiptare. Nga verifikimi paraprak konstatohet se kërkesa ankimore është brenda afatit të përcaktuar si dhe plotëson elementët formalë të parashikuara në nenet 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor. Për këto arsye, ne i propozojmë KAS-it kalimin e kërkesës për shqyrtim, faleminderit!

Z. K. Bele: Përtej arësytimit ligjor për sa i përket formulimit të kërkesës, unë e lexoj këtë e përveç anës drejtshkrimore që është e tmerrshme, nuk shoh as të citohen disa prova bashkëlidhur, nuk shoh ndonjë analizë ligjore. Mendoni se duhet kaluar në seancë? Apo, më fal ju mbajtët qëndrim!

Znj. M Koja: Ne u shprehëm me propozimin që KAS-i ta shqyrtojë kërkesën ankimore të partisë.


Z. K. Bele: KAS i konsultuar në vend, vendosi:

- Kalimin për shqyrtim themeli të kërkesës ankimore nr. 6.
- Bashkimin me kërkesën ankimore nr. 5.

Lidhur me momentin e seancës së përbashkët, do të shprehem në varësi të kërkesave të tjera në një moment të dytë në përfundim të shqyrtimit paraprak të këtyre dy kërkesave të cilat janë njëra pas tjetrës. Me kaq shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 6, deklarohet i mbyllur.

Vendimi nr. 10

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



4.06.2024

Ora, 11:04

RENDI I DITËS

“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 7, datë 29.5.2024 të depozituar nga subjekti “Bindja Demokratike”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. I. Rusmali,
z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. J. Josifi, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** PSSH (znj. Sh. Ballhysa, znj. Dh. Isufaj)
BD (z. F. Topollari)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. K. Bele: Vazhdojmë me shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 7, subjekti ankues Partia Bindja Demokratike. Prezent trupa e KAS-i me të pestë anëtarët. Prezent administrata e KQZ-së, drejtuar nga zonja Koja. Përfaqësuesi i ankuesit!?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Fabian Topollari, kryetari në detyrë.

Z. K. Bele: Faleminderit zoti Topollari! Ju lutem dy fjalë në lidhje me me thelbin e kërkesës dhe me shkaqet nëse kalon apo jo për shqyrtim në themel, zonja Koja!

Znj. M. Koja: Ndaj vendimit të KSHZ nr. 38, të vitit 2024 “Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i raporteve financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022”, ka paraqitur kërkesë ankimore Partia Bindja

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Demokratike, nëpërmjet kërkesës ankimore nr. 7, datë 29.05.2024. Nga verifikimi paraprak konstatohet se kërkesa ankimore është depozituar brenda afatit të caktuar si dhe plotëson elementët formalë të parashikuara në nenet përkatëse të Kodit Zgjedhor. Edhe në këtë rast, i propozojmë KAS-it kalimin e kërkesës për shqyrtim.

Z. K. Bele: Zoti Topollaj qëndrimi juaj?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Unë pa u futur në themel, sepse nuk jemi në atë moment procedural, dua vetëm t'ju njoftoj se ne jemi vënë në dijeni të këtij vendimi dhe arsyeja se pse ne jemi penalizuar e kam marrë vesh vetëm nga baza ligjore. Është një vendim që për secilën parti përcakton gjobën përkatëse dhe një nen i Kodit Zgjedhor, pa paraqitur asnjë provë dhe asnjë fakt. Nga baza ligjore kam kuptuar se jemi penalizuar për faktin se pretendohet se nuk kemi bashkëpunuar me audituesin. Do të ishte mirë që nëse ka ndonjë provë, organi që e ka marrë vendimin të na bëjë një parashtrim më të gjerë, sepse e kemi të vështirë dhe për t'u mbrojtur edhe në shqyrtimin në themel...

Z. I. Rusmali: Në themel, ose kërkoni raportin e auditit t'ju vihet në dispozicion.

Z. K. Bele: Besoj se raporti është publik, apo jo?! Është publik në faqen e KQZ-së.

Z. I. Rusmali: Shkaqet janë te raporti...

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Dakord!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

...dhe të indikuara shkurt te vendimi, për shkak të volumit na është relatuar në seancë paraprake për një ankim të ngjashëm...

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Dakord!

Z. K. Bele: ...duke thënë këtë, në shqyrtim në themel, patjetër do të të trajtohen këto që ju ngrini. Mirë! KAS i konsultuar në vend, vendosi:

- Kalimin për shqyrtim në themel të kërkesës ankimore nr. 7, me ankues Partinë Bindja Demokratike.

- Bashkimin me kërkesën ankimore nr. 5 dhe 6 të relatuar më parë.

Të treja kërkesat do të shqyrtohen bashkarisht në një seancë të vetme e caktuar për ditën e sotme.

Paraprakisht ju pyesim nëse keni ndonjë..


Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Kam nevojë për kohë që të konsultoj raportin, se nuk e kam lexuar raportin.

Z. I. Rusmali: Një paragraf keni në raport.

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Dakord në qoftë se më ndihmoni, dakord jam.

Vendimi nr. 11

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

4.06.2024

Ora, 11:13

RENDI I DITËS

Për shqyrtimin e:

Kërkesës ankimore nr. 05, datë 8.05.2024 të depozituar nga subjekti “Partia Socialiste e Shqipërisë”;

kërkesës ankimore nr. 6, datë 22.5.2024, të depozituar nga subjekti “Partia Ardhmëria Shqiptare”;

kërkesës ankimore nr. 7, datë 29.5.2024 të depozituar nga subjekti “Bindja Demokratike”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. I. Rusmali, z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. J. Josifi, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** PSSH (znj. Sh. Ballhysa; znj. Dh. Isufaj)
BD (z. F. Topollari)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve. Deklarojmë të çelur seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 5, të cilës i janë bashkuar gjithashtu kërkesa ankimore me nr. 6 dhe me nr. 7, të cilat i takojnë përkatësisht subjekteve politike: Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Ardhmëria Shqiptare dhe Partia Bindja Demokratike. Relator i kësaj çështje jam përcaktuar unë, meqenëse isha dhe relator i kërkesës ankimore me nr. 5, unë anëtar i KAS-it Elvis Çefa. Deklarojmë seancën të hapur, duke filluar

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

fillimisht me verifikimin e prezencës! Është prezent trupa e plotë e KAS-it. Është prezent administrata e KQZ-së, në drejtimin e drejtoreshës juridike zonjës Madalena Koja, që në këtë procedim administrativ do të përfaqësojë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Janë prezent dy përfaqësues nga subjekti ankimues Partia Socialiste e Shqipërisë. Ju lutem prezantohuni!

Znj. Sh. Ballhysa, përfaqësuese e PSSH: Shila Ballhysa dhe kryefinancierja e partisë zonja,

Znj. Dh. Isufaj: Dhurata Isufaj!

Z. E. Çefa: Është prezent edhe përfaqësuesi i Partisë Bindja Demokratike.

Z. F. Topollari: Fabian Topollari!

Z. E. Çefa: Faleminderit! Nuk ka prezencë të përfaqësuesit, të ankimuesit që i përket Partisë Ardhmëria Shqiptare. Ndërkohë ne do të vijojmë me dëgjimin e palëve dhe të pretendimeve dhe eventualisht do të vendosim pastaj se si do të procedojmë në mënyrë që t'i japim mundësinë dhe ankimuesit tjetër të dëgjohet në këtë procedim administrativ. Atëherë, fillimisht po i jap fjalën administratës së KQZ-së, për të na parashtruar në mënyrë të përmbledhur rrethanat dhe faktet të cilat pak a shumë janë të njëjta për të tre kërkesat ankimore. Zonja Koja, shkurtimisht ju lutem, fjala për ju!

Znj. M. Koja: Faleminderit! Atëherë, referuar ligjit “Për Partitë Politike”, të ndryshuar dhe udhëzimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, kontrollin dhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre dhe mënyrën e pagesës së audituesve”, është përcaktuar që brenda datës 31 mars të çdo viti kalendarik, partitë politike që janë të regjistruara në regjistrin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, janë të detyruara të dorëzojnë raportin financiar për vitin kalendarik. Sipas të dhënave të Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, deri në datën 31 Dhjetor 2022, figurojnë të regjistruara njëqind e tridhjetë e një parti politike. Nga këto, 48 parti dorëzuan në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raportin financiar vjetor për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022. Dorëzimi i raportit është bërë brenda datës 31 Mars 2023, si afat i përcaktuar nga ligji. KQZ ka caktuar auditues për gjitha raportet financiare të subjekteve zgjedhore. Konkretisht, audituesja që ka audituar raportin financiar për Partinë Socialiste të Shqipërisë, ka konstatuar si më poshtë vijon:

Së pari, partia nuk ka llogaritur amortizim për ndërtesën që e ka në huapërdorje sipas vendimit nr. 196, datë 19.5.1992 të Këshillit të Ministrave. Vlera e ndërtesës me huapërdorje nuk është e rivlerësuar sipas kërkesave ligjore dhe paraqitet me vlerën e vitit 1993. Llogaritja e amortizimit bëhet sipas kërkesave të ligjit në fuqi me nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar.

Së dyti, partia nuk ka paraqitur të ndarë aktivitetin e saj vjetor të zakonshëm dhe aktivitetin për fushatën zgjedhore të datës 6.03.2022.

Së treti, pagesat e kryera për shpërblimin e fund vitit si dhe pagesat për punë shtesë nga disa punonjës të saj, nuk janë përfshirë në listë pagesat e raportuara në organet fiskale. Për të gjitha këto pagesa, është llogaritur dhe është raportuar gabim tatimi në burim me tarifë 15%, kur duheshin raportuar si të ardhura personale duke llogaritur tatimin mbi pagën për secilin punonjës. Nuk janë kaluar nëpërmjet llogarive bankare pagesat ndaj disa punonjësve të jashtëm që kanë punuar për llogari të partisë, si dhe pagesat e shpërblimit të fund vitit. Në këto kushte, për sa më lart

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

konstatuar nga audituesi, Komisioneri pasi mori në shqyrtim dhe miratoi raportin e gjetjeve, ka vendosur marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 60 000 lekë, për Partinë Socialiste të Shqipërisë, në zbatim të nenit 23/4, pika 1, të ligjit “Për Partitë Politike”. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Fjalën po ja jap përfaqësuesit të Partisë Socialiste. Shkurtimisht ju lutem, na jepni argumentet tuaja, pse e kundërshtoni këtë! Pra, qëndrojnë apo jo konstatimet dhe më pas dhe argumentat për ta kundërshtuar.

Znj. Sh. Ballhysa, përfaqësuese e PSSH: Të nderuar anëtarë të KAS-it! Ne kemi kërkuar nga ju shfuqizimin e pikës 5, të vendimit nr. 38, datë 9.4.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për sa i takon marrjes së masës administrative për Partinë Socialiste të Shqipërisë, për këto arsye:

- Referuar pikës nr. 46 të vendimit nr. 38/2024 të KSHZ, ku audituesja ka konstatuar se nuk është llogaritur amortizimi për ndërtesën në huapërdorje dhe mosrivlerësimi e vlerës së kësaj ndërtese, ju bëjmë me dije se kemi një vendimi të Këshillit të Ministrave dhe shkresën nr. 1211/1, datë 20.05.1992, ku përcaktohet se ndërtesën e kemi në përdorim dhe jo në huapërdorje. Si rezultat, që në fillim për efekt raportimi i është vënë vlera 1.643.389 lek. Kjo vlerë është raportuar e njëjtë për 30 vjet në pritje të kalimit në pronësi dhe kjo është dhe arsyeja e mos rivlerësimit dhe për rrjedhojë dhe llogaritjes së amortizimit.

- Konstatimi tjetër se nuk është paraqitur i ndarë aktiviteti vjetor i partisë dhe aktiviteti për fushatën zgjedhore të 6 Marsit 2022, nuk qëndron, sepse në bilanc është përfshirë si aktiviteti vjetor i zakonshëm, ashtu edhe aktiviteti për fushatën e 6 Marsit, dhe këtë fakt e ka cilësuar edhe vetë audituesja.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

- Për pagesat e shpërblimit të fundvitit dhe të punonjësve me honorar gjithashtu nuk qëndron pretendimi që është llogaritur gabim tatimi i pagave, gjë që i është argumentuar auditueses me dokumenta përkatëse nga kryefinancierja e partisë, e cila është këtu me mua për çdo pyetje specifike që mund të keni lidhur me këtë çështje. Punonjësve në organikë tatimi i shpërblimit të fundvitit i'u është llogaritur sipas ligjit, por raportimi është bërë te deklarimi i tatimit në burim. Pavarësisht kësaj, shpërblimi i fundvitit në vazhdim të 2023 është bërë sipas rekomandimeve të auditueses.

- Së fundi, lidhur me konstatimin e pagave të punonjësve me honorar, janë menduar që të jepen me arkë, sepse pavarësisht faktit se si paguhen, rëndësi ka që të paguhen detyrimet tatimore ndaj shtetit, gjë të cilën Partia Socialiste e Shqipërisë e bën rregullisht. Por pavarësisht nga kjo, me rekomandimin e auditueses, që nga nëntori 2023 këto pagesa janë kaluar nëpërmjet llogarive bankare.


Për të gjitha këto arsye, kërkojmë nga ju shfuqizimin e pikës 5, të vendimit nr. 38, datë 9.04.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit! Pyetje nga kolegët?

Z. I. Rusmali: Nëse ka diçka për të shtuar shefja e financës!

Z. K. Bele: Paraprakisht kam një pyetje, nëse dëgjova drejt. Ju thatë që është bërë riparimi, ose më saktë, është marrë në konsideratë rekomandimi dhe është bërë menjëherë. Pra, brenda vitit fiskal?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Znj. Dh. Isufaj: Auditimi u bë në nëntor dhe ne që në dhjetor, pagat e punonjësve që kemi me honorar i kaluam me bankë, meqenëse na u la si detyrë. Pra, menjëherë pasi mbaroi auditimi.

Z. K. Bele: Ju kuptova, faleminderit!

Z. E. Çefa: Pyetje të tjera? Po zoti Braho!

Z. L. Braho: Kam një pyetje me këtë pjesën e parë që ka të bëjë me rivlerësimin e godinës, ose më saktë amortizimin e ndërtesës që ka në huapërdorje. Tani, rivlerësimin sipas kërkesave ligjore, duhet ta bëjë Partia Socialiste që e ka në huapërdorje, apo pronari?

Znj. Dh. Isufaj: Jo! unë e kam atë në përdorim. Për deri sa e kam në përdorim, ne qëkurse na është dhënë nuk kemi bërë asnjë rivlerësim dhe asgjë tjetër në raport me godinën, duke pritur të na kalojë në pronësi. Në momentin që do të na kalojë në pronësi atëherë do të bëhet rivlerësimi dhe të gjitha.

Z. K. Bele: Kalon apo jo në pronësi është diçka tjetër. Çështja është detyrimin e ka qiramarrësi, apo pronari i godinës?

Znj. Dh. Isufaj: Që kur ka dalë vendimi, i është lënë si detyrë në atë kohë, Komitetit Ekzekutiv dhe sot bashkisë, që të bëjnë veprimet e mëvonshme dhe që në atë kohë e deri më tani, nuk është bërë asgjë nga ana e tyre, bëhet fjalë që në 1993.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Z. L. Braho: Po pse thoni atëherë që kur ta merrni në pronësi?! Nuk besoj se kalojnë në pronësi të partive ato, në huapërdorje janë?

Znj. Dh. Isufaj: Jo kush tha?! Ne kemi godina psh në Has që i kemi kaluar në pronësi...

Z. L. Braho: Bëhet fjalë për selinë e partisë këtu në qendër?

Znj. Dh. Isufaj: Po, për selinë po flasim.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Unë kam një pyetje në fakt për administratën, sepse për hir të së vërtetës, ky vendimi është shumë telegrafik. Nuk ka shumë argument dhe meqenëse po diskutojmë gjëra thellësisht teknike do të kisha vlerësuar një material shtesë bashkë me raportin. Pra, argumente pak më të plota lidhur me shkeljet e pretenduara. Në qoftë se pretendohet, po themi, nga subjekti është kryer një shkelje, mirë do të ishte të referohej edhe baza ligjore. Në kundërshtim me kë ligj, apo akt nënligjor vjen në kundërshtim ky veprim. Në mënyrë që dhe ne të kemi mundësi të gjykojmë në mënyrë të paanshme dhe mënyrë shteruese për këto. Pra, pyetja është, në qoftë se është e mundur për administratën, të paktën për tre subjektet ankimuese, ka dokumenta shtesë nga ekspertët kur kanë bërë raportin, të na i vini në dispozicion qoftë dhe pas seancës që t'i shohim dhe vlerësojmë ne. Pyetje të tjera?

Z. K. Bele: Në se mund të arësyetoni në se e dini, se kjo është shumë teknike, lidhur me këtë që ka ngritur audituesi. A qëndron nga pikëpamja ligjore detyrimi për t'u bërë rivlerësimi nga huamarrësi në huapërdorje të objektit, apo jo?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Znj. J. Josifi: Në raportin e auditimit, audituesja në përfundim në sintezën e gjetjeve përfundimtare dhe listës së parregullsive të gjetura gjatë auditimit, ka dhënë dhe bazën ligjore mbi të cilën argumenton që “amortizimi, do të duhej llogaritur për gjatë të gjitha viteve..” por po flasim specifikisht për këtë vit financiar, “... nga përdoruesi”. Konkretisht është pika 2 e gjetjeve “b”, në përfundimet e raportit të auditimit. Është në raportin e auditimit, jo në raportin përmbledhës të gjetjeve të miratuar nga Komisioneri.., për këtë parti. Mundet t’jua jap?

Z. E. Çefa: Po, patjetër! Këto raportet e auditimit do të na duhen për të tre subjektet ankuese, t’i kemi paraprakisht.

Znj. J. Josifi: Dakord!

Z. E. Çefa: Do t’u jepet dhe përfaqësuesve të partive ankimuese.

Znj. J. Josifi: Për të vijuar argumentimin e auditueses në rastin e subjektit ankues Partia Socialiste, ajo e ka mbështetur kërkesën e saj, në ligjin 8438/1998 i ndryshuar, “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 22, pika 1, germa “b”, në përcaktimin e fitimit të tatueshëm. “Amortizimi për aktivet e veprimtarisë, llogariten nga: a) pronari aktiveve të veprimtarisë në të gjitha rastet përveç atyre të përmendura në shkronjën “b” të këtij neni. Në rastet e aktiveve të dhëna me qera, me huapërdorje, ose në një formë tjetër të parashikuara në dispozita ligjore, nga personi që mbart riskun për humbjen, apo shkatërrimin e aktivitetit”. Pra, nga personi që e ka në përdorim. Ky është detyrimi sa i takon amortizimit. Udhëzimi që vijon i Ministrisë së Financave në zbatim të këtij ligji, është udhëzimi nr. 5, dt. 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe ky udhëzim i ndryshuar. Specifikisht thotë “personat që llogarisin

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

amortizimin”, pika 3, pikë 7, pikë 1. Në zbatim të nenit 22 të ligjit që sapo citova, “amortizimi aktiveve, llogaritet nga pronari i aktiveve, b) personi që mbart riskun në rastin e aktiveve të dhëna me qera, apo huapërdorje afatgjata...” siç është ky rast...


Z. K. Bele: Më fal, një pyetje kam, pse e marrim të mirëqenë që riskun e ka huapërdorësi? Për paralelizëm, më ka ndodhur të jap me qera një ambjent dhe të gjitha risqet në kuptueshmërinë time, i ka ai tjetri. Pse e ka riskun huapërdorësi, apo pronari? Ku dallohet? Ka një kontratë që e përcakton këtë apo..., kjo është rast pas rasti?

Znj. J. Josifi: Qëllimi i pasqyrave financiare që dorëzohen dhe sidomos i raportit financiar vjetor, pra jo të aktivitetit për fushatë zgjedhore është që t’i japim vlerën neto të pasurive, të çfarëdolloj forme qofshin ato që zotëron partia, qoftë në përdorim, qoftë që i ka në pronësi. Kjo do të thotë që vlera që ka kjo ndërtesë të paraqitur në raportin financiar nuk është reale, nuk është vlera neto e vërtetë e asaj pasurie. Le të jetë ajo në përdorim. Ajo godinë nuk ka vlerë sot 1.6 milion lekë dhe arësytimi...

Znj. Dh. Isufaj: Jemi në 1992...

Znj. J. Josifi: Po në 1992, por sot jemi në 2024! Në 1992 kishte një vlerë të caktuar që do të thotë që dhe nëse rivlerësimin, sigurisht do të duhej ta bënte pronari i ndërtesës, kjo do të duhej të vinte me një kërkesë të përdoruesit. Përdoruesi, që në rastin konkret është partia, në argumentin e saj nuk thotë këtë, nuk thotë që është gabim të llogarisësh amortizimin. Shprehet se “ne nuk e kemi llogaritur amortizimin, sepse vlera është 1.6 milion lekë dhe kjo vlerë është e raportuar njësoj për 30 vite.


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Presim kalimin në pronësi dhe kjo është arsyeja e mos rivlerësimit”. Nëse ata do ta kishin amortizuar çdo vit në pasqyrat e tyre financiare, nga viti 1992 deri më sot, vlera e godinës do të ishte me minus praktikisht. Arsyeja praktike pse ata nuk e kanë deklaruar amortizimin, nuk kanë ardhur duke ja ulur vlerën, nuk është arsye për të mos e zbatuar ligjin. Përdoruesi, ka pasur të gjithë mundësinë, t’i kërkojë pronarit shtet, të kryejë rivlerësimin e godinës, rivlerësim i cili me logjikë do të kishte një vlerë më të lartë në vitin 2024 se sa 1.6 milion dhe në këtë rast do të ishte rritur, po themi kështu pasuria neto, në përdorim e kësaj partie. Pritja për të kaluar në pronësi është një hipotezë e pabazuar askund, sepse siç është dhënë në përdorim, godina dhe mund të tërhiqet nga përdorimi. Pyetja tjetër, por kjo është retorike nuk e kemi për askënd është në gjithë këto vite përdorim, ekzaktësisht 30 vjet, nga viti 1992, në vitin 2022 që po flasim, a janë kryer punime rehabilitimi të ndonjë lloji të brendshëm të kësaj godine? Nëse po, a janë deklaruar këto shpenzime? A nuk ja kanë rritur vlerën 1.6 milionshit këto? Kjo është vlera reale e pasurisë neto në këtë rast në një ndërtesë. Ti merr vlerën të rivlerësuar, thuaj çfarë ke shpenzuar për të? Ja ke rritur, ose ja ke ulur vlerën, se kjo godinë qenka shumë e amortizuar, duhet të kishte rënë praktikisht sot, nëse po marrim këtë logjikë si në letra. Sa i takon konstatimit nr. 2 që nuk është ndarë aktiviteti i zgjedhjeve nga ai vjetor, audituesja e ka pranuar që ka një ndarje, por ajo është vetëm te shpenzimet. E keni në raportin e auditimit. Në raportin financiar të vitit 2022 ka deklaruar me të drejtë totalin e shpenzimeve më vehte për fushatën e 6 marsit, por jo të të ardhurave. Ishte e vështirë për audituesen të kuptonte ç’të ardhura janë përdorur gjatë fushatës si pasojë e fushatës dhe cilat të ardhura në aktivitetin rutinë të partisë. Po marr si shembull kuotizacionet e partisë. Partia Socialiste në raportin vjetor financiar, ka deklaruar të ardhura vjetore, kuotizacionet për tre bashki, Rrogozhinë, Tiranë dhe pjesërisht Durrës dhe i ka deklaruar në vjetorin e vitit 2022, por ka llogaritur të gjitha

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

kuotizacionet e tjera në raportin financiar të 6 marsit. Pra, duke mos e ndarë aktivitetin për zgjedhje nga ai vjetor, që në rastin e raportimit vjetor është i thjeshtë. Për zgjedhje ka një raport më vehte i cili dhe ai auditohet, me të drejtë. Partia thotë “kemi raportuar, është audituar”, jemi dakord deri këtu. Por, ata duhet të kishin thënë një zë total për zgjedhjet e 6 marsit, në raportin vjetor të vitit 2022 dhe një zë në total për të ardhurat e 6 marsit. Thjesht në total nuk do të hynin më në raportim analitik, kur vjen puna te raporti vjetor. Tani sa i takon pikës 3...

Z. I. Rusmali: Siç bëre te pika e parë, do të doja të na jepje referencën, bazën ligjore të shkeljes. Kush ligj e ka përcaktuar detyrimin për raportimin e ndarë, cili ligj e ka përcaktuar këtë gjë?

Znj. J. Josifi: Aktet nënligjore të KQZ-së, udhëzimi i Komisionerit që përcakton raportimin financiar vjetor.

Z. I. Rusmali: Dakord!


Z. L. Braho: Partia Socialiste, besoj... kjo pjesa e auditimit është e përvitshme, apo është me short dhe ka qenë hera e parë që i ka rënë për t’u audituar?

Znj. J. Josifi: Jo, auditohet çdo vit. Shorti lidhet me cili auditues, auditon cilin vit.

Z. L. Braho: Në auditimet e mëparshme është hasur ndonjëherë kjo problematika me këtë godinën?

Znj. Dh. Isufaj: Asnjëherë! Se zonja nuk besoj se e di se është e re... madje...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Z. E. Çefa: Ju lutem do t'jua jap unë fjalën, por pyetja ishte për përfaqësuesen e KQZ. Do të përgjigjet zonja, pastaj e keni ju!

Znj. J. Josifi: Jemi duke shqyrtuar raportin financiar vjetor të vitit 2022 dhe raportin e auditimit për këtë vit financiar. Nuk është relevante...

Z. L. Braho: Jo, jo është relevante sepse në qoftë se është një shkelje e përsëritur është tjetër gjë.

Znj. J. Josifi: Është shkelje e përsëritur, po nuk është konstatuar nga audituesit më parë. Kjo nuk do të thotë që audituesi i parë që e konstatoi bëri gabim. Ka treguar saktësi për mendimin tim.


Z. L. Braho: Jo, jo nuk po them këtë, thjesht dua të di si ka qenë ecuria.

Znj. J. Josifi: Është raportuar nga partia me të njejtën vlerë përgjatë gjithë viteve, të paktën që kur ka filluar të raportohet me këtë format në KQZ dhe nuk është konstatuar si shkelje më parë.

Z. L. Braho: Pastaj i bie të merren masa për ata audituesit e mëparshëm, sepse ka një gjë që nuk shkon në këtë histori.

Z. E. Çefa: Ilir, pyetje tjetër? S'kishe? U sqaruan! Atëherë, vazhdojmë aty ku ishim!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Znj. J. Josifi: Edhe dy pikat e tjera të lutem! Për pikat 3 dhe 4, pagesat e shpërblimit të fundvitit për punonjësit e partisë, por dhe për punonjësit me honorar. Audituesja nuk ka ngritur pretendimin se tatimi nuk është mbajtur, ose vlera e tatimit të mbajtur është e gabuar. Vlera e tatimit të mbajtur përputhet, por në organet tatimore, partia nuk ka deklaruar listë pagesën e shpërblimeve. Shembull praktik, për muajin dhjetor, kur mendohet se punonjësit marrin një shpërblim, paga është më vehte në një listë pagesë më vehte të pagave, ku tatóhet sipas legjislacionit në fuqi. Ka dhe një listë pagesë më vehte për shpërblimet, e cila tatóhet me 15%. Partia ka deklaruar tatimin në burim, por nuk ka dërguar listë pagesë dhe nuk i ka kaluar këto pagesa punonjësve të saj me bankë. Kjo është çfarë pretendon audituesja dhe kjo është çfarë pranon partia, përderisa menjëherë e ka reflektuar rekomandimin e auditueses, që do të thotë..., shpërblimet janë paguar nga arka.

Z. E. Çefa: Po zoti Rusmali!

Z. I. Rusmali: Edhe këtu do të doja të lutem, cilat janë dispozitat e shkelura? Cilit ligj i përkasin? Ç'nen është shkelur, në cilin ligj, në kryerjen e këtij veprimi?

Znj. J. Josifi: Në rastin e pagesës nga arka dhe jo nga banka, nuk ka një shkelje. Pra, mundet që pagesa të kalojë nga arka, por për hir të gjurmimit financiar dhe transparencës, ato do të duhet të kishin kaluar me bankë, sepse këta nuk janë punonjës të cilët nuk janë të partisë. Pra, për të njejtin muaj, partia u ka derdhur në llogaritë e tyre bankare, pagën përkatëse. Kështu që nuk kishte pse të mos e bënte këtë gjë për shpërblimet. Ajo që ndodh është se nëse një pagesë jepet nga arka, e çfarëdolloj subjekti, mënyra e vetme për ta vërtetuar atë është një mandat pagesë e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

cila firmoset nga personi, por nuk është një transaksion i gjurmueshëm që të mund t'ia rimbursosh këtë pagesë në llogarinë e tij.

Z. I. Rusmali: Dorëzimi i listë pagesave, nga cili ligj imponohet?

Znj. J. Josifi: Tatimor! Nga legjislacioni tatimor dhe duhet që të deklarohen punonjësit...

Z. I. Rusmali: Ndonje referencë konkrete ka?


Znj. J. Josifi: E gjejmë menjëherë.

Z. I. Rusmali: Dakord!

Z. E. Çefa: Atëherë, përfaqësuesja e Partisë Socialiste, çfarë keni për të na thënë në lidhje me këto gjetje që na u relatuan në mënyrë më specifike?

Znj. Dh. Isufaj: Ne, që kur është vlerësuar godina dhe siç e kemi parashtruar, nuk kemi bërë rivlerësimin me idenë që herë pas here do të bëhej kalimi në pronësi, ndaj nuk është bërë. Riparimet e ndryshme që kemi bërë në godinë i kemi kaluar tek shpenzimet e institucionit. Të gjithë audituesit, mund të them që kemi filluar diku nga viti 2009 që auditohemi nga KQZ-ja dhe shpenzimet janë reflektuar për riparimet e ndryshme që kemi bërë në godinë. Pra, jo te godina, por tek “shpenzime”, sepse gjithmonë kemi pritur. Edhe audituesit e tjerë që kanë ardhur, thjesht për sqarim, na kanë thënë “pse e lini ende kështu?”. Ne u jemi përgjigjur që “po presim që institucionet që kemi më lart të vendosin për këtë”. Por, në një vendim

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

të firmosur nga Aleksandër Meksi thuhet “Për problemet e selive të partive..” më 20.05.1992, “... dhe shtypit të tyre, vlerën e qerasë që do të përballojë shteti, si dhe detyrimet në përdorimin e tyre, qeveria ka ngritur një grup pune për të përcaktuar rregullat e nevojshme”. Gjë të cilën, ne që atëherë nuk kemi ndonjë gjë të re, ndaj ka vazhduar kjo gjë. Tjetër, unë i kisha hedhur shpenzimet e fushatës dhe ajo i ka hedhur shpenzimet dhe zonja e di shumë mirë që këto shpenzime kanë dhe të ardhurat e tyre. Tjetër se ajo nuk ka dashur t’i hedhë aty. Siç është bërë auditimi i fushatës dhe shpenzimet kanë qenë “kaq” edhe të ardhurat kanë qenë “kaq”. Megjithatë, është e drejta juaj ta diskutoni si shkelje, por ajo e ka shkruar në material “shpenzimet e fushatës”. Auditimi i fushatës është bërë i veçantë dhe nuk është gjetur asnjë shkelje.

Z. I. Rusmali: Të lutem, se kjo më duket e paqartë. Ju mohoni ekzistencën e faktit? Ju thoni që në raportin tuaj janë deklaruar dhe shpenzimet dhe të ardhurat e fushatës në mënyrë të veçantë?


Znj. Dh. Isufaj: Jo, shpenzimet i ka përcaktuar ajo si të veçanta edhe në material audituesja...

Z. I. Rusmali: Edhe njëherë, ju si i keni raportuar? Nuk është puna si i ka përcaktuar ajo!

Znj. Dh. Isufaj: Jo, jo! Unë të ardhurat i kam raportuar në total!

Z. I. Rusmali: Dhe shpenzimet ne total?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Znj. Dh. Isufaj: Jo, shpenzimet i ka gjetur ajo të veçanta për fushatën, sepse janë të ardhura të cilat i kam pasur nga të ardhurat e mia. Flasim për zgjedhjet e 22..

Z. I. Rusmali: Biem dakord të dy palët që fakti ekziston, dakord, mirë!

Znj. Dh. Isufaj: Po! Shpenzimet janë më vehte, të ardhurat nuk janë veçmas.

Z. I. Rusmali: Shpjegimet për të tjerat?!

Znj. Dh. Isufaj: Për honorarin. Ne kemi punonjës të cilët për punën e tyre, kemi një shkresë të veçantë, që janë në vend tjetër dhe i paguajmë me honorar. I kemi paguar me bankë, por në zyrën e detyrimit të tatimeve, nuk bëhet për personat me honorar me emër të veçantë siç e kërkonte zonja, se nuk e përmban formati. Format i është i tillë që për këto bëhet burimi në natyrë dhe atëherë aty është lista e këtyre personave. Pra, te tatimet shkon në total, nuk shkon me emra, sepse nuk ka një mundësi..

Z. I. Rusmali: Pra, mbajtja e tatimit në burimi shkon si total?

Znj. Dh. Isufaj: Po, nuk shkon me emra.

Z. I. Rusmali: Kështu janë rregullat fiskale?

Znj. Dh. Isufaj: Po, për honoraret.

Z. K. Bele: Ndërkaq thatë ju, evidentohen në një listë, e kuptova...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Znj. Dh. Isufaj: Jo lista është tek unë!

Z. K. Bele: Ah, dakord!

Znj. Dh. Isufaj: Lista është tek unë dhe secili për të ardhurat që ka, mban përgjegjësi vetë për të raportuar, në lidhje me atë që tha zonja “kush ka marrë e kush s’ka marrë”. Secili mban përgjegjësi vetë. Tani, meqenëse audituesja lë një detyrë dhe thotë që “këto..” për mua nuk ka rëndësi se ia kam dhënë me arkë, apo me bankë. Për mua ka rëndësi që unë të jem, në rregull me detyrimet karshi shtetit për këtë person që i kam dhënë pagën dhe kjo është e llogaritur...

Z. I. Rusmali: Dakord, ju thoni që, ju nuk keni detyrim që të çoni listë pagesën e honorareve tek tatimet

Znj. Dh. Isufaj: Jo!

Z. I. Rusmali: Ky detyrim për ju nuk ekziston, thoni ju?!

Znj. Dh. Isufaj: Jo, se nuk e ka sistemi!

Z. I. Rusmali: Dakord! Honoraret janë një gjë dhe shpërblimet për Vitin e Ri janë një gjë tjetër. Na e shpjegon të njejtën gjë për shpërblimet?

Znj. Dh. Isufaj: Për shpërblimet, të themi të drejtën, vendosi personi që ka tagrin, u miratua ajo gjë. Ne bëmë borderoja dhe u pa e arësyeshme që t’ua japim me arkë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Por kur u bënë llogaritjet, u bënë sipas ligjit, që mbi 300 000, mbi 150 000, sipas rregullit. Unë kam sjellë dhe borderonë këtu!

Z. I. Rusmali: Ju lutem, edhe njëherë! Administrata e KQZ-së thotë që “ju, duke bërë pagesën në dorë të shpërblimit të Vitit të Ri, nuk keni bërë asnjë shkelje fiskale”, thotë zonja., nuk besoj se do ta kundërshtoni këtë? Pyetja është kur keni mbajtur tatimin në burim për shpërblimet...

Znj. Dh. Isufaj: Nuk e kam derdhur për secilin me emër më vehte, por e kam derdhur tek tatimi në burim.

Z. I. Rusmali: Edhe njëherë, edhe kjo është në total, pa listën e personave përfitues, në tatimet?

Znj. Dh. Isufaj: Po! Lista është këtu dhe mund ta shihni.

Z. I. Rusmali: Ju pretendoni se dhe për shpërblimet e Vitit të Ri, nuk ekziston detyrimi për të bërë deklarinimin me listë pagesë për personat?

Znj. Dh. Isufaj: Unë nuk e kam bërë për persona. Por, unë me detyrat që la ai, shpërblimin Vitit të Ri 2023 e kam bërë te programi, një nga një dhe e kam riparuar.

Z. I. Rusmali: Nuk na intereson kjo! Edhe ju tani e perceptoni që tek organet tatimore duhet bërë me listë pagesë?

Znj. Dh. Isufaj: Përderisa ma la si detyrë, patjetër! Hyra në sistem dhe e bëra.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Z. I. Rusmali: Detyra njerëzit mund të lënë shumë, pyetja jonë është si është ligji? Në perceptimin tuaj tani, e ndjeni si detyrim ta bëni, sepse ua kërkon ligji, apo jo?

Znj. Dh. Isufaj: Në perceptimin tim përpara, për mua ishte që detyrimet karshi shtetit të ishin në rregull dhe po e lënë audituesja shënimin. Por, tani e perceptoj dhe unë që duhet bërë më vehte shpërblimi duke e shtuar tek emri i tij në sistem. Por, nuk ka shkelje tatimore fare, se detyrimi karshi shtetit...

Z. I. Rusmali: Debati tek ne është duke mos çuar listë pagesat tek tatimet, keni shkelur ligjin fiskal shqiptar, apo jo? Kjo është pyetja për ne!

Znj. Dh. Isufaj: Për mua jo! Unë e kam mbajtur detyrimin fiskal në një formë tjetër.

Z. I. Rusmali: Dakord, duhet të provojë administrata se cili ligj është shkelur në këtë rast!


Znj. Dh. Isufaj: Dakord! Unë nuk kam bërë shkelje se detyrimin e kam derdhur, jo me emër të veçantë, por në total.

Z. I. Rusmali: Dakord, në rregull!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Po!

Znj. Dh. Isufaj: Për sa i takon punonjësve me honorar i qëndroj përsëri asaj që mund ta marrin edhe në arkë. Meqenëse na u la si detyrë, për mua nuk ka problem fare

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

nëse e jap me arkë, apo me bankë. Mjafton që unë këtë personi, tatimin në burim ja mbaj dhe e çoj tek Drejtoria e Tatimeve për detyrimet kundrejt tyre.

Z. K. Bele: Për çfarë vlerash bëhet fjalë, thjesht për ta kuptuar?

Znj. Dh. Isufaj: Aty kemi punonjës që janë me pagë bruto 80 000, kemi dhe me 60 000 dhe me 40 000, për honoraret.

Z. K. Bele: Po, për shpërblimet?

Znj. Dh. Isufaj: Shpërblimet 40 000 lekë në fund të vitit.

Z. K. Bele: Kuptova!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Unë kam një pyetje për administratën. Tani.., duhet ta shohim pak më larg këtë çështje. Komisioneri e ka klasifikuar shkelje këtë, për efekt të gjobitjes i ka klasifikuar në pikën 1, të nenit 23/4, të ligjit “Për Partitë Politike”. E cila thotë: shkelja e dispozitave për financimin e partive politike, nga ana e personit përgjegjës”. Tani, pyetja ime është, këto shkelje nëse i prezumojmë të mirëqena, a janë shkelje të dispozitave për financimin e partisë, apo janë shkelje të procedurave të kontabilitetit të partisë? Në opinionin tim, janë dy koncepte të ndryshme.

Znj. J. Josifi: Është e dyta, por e dyta të çon tek e para, sepse ju thashë që ky raport nuk tregon pozicionin financiar real të partisë. Pra, mosdeklarimi i pagesave kundrejt punonjësve të deklaruar të partisë. Pra, shpërblimi i fundvitit bëhet për punonjësit që partia i ka të deklaruar në sigurime si punonjës të saj. Dakord? Është

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

njëlloj si shpërblimi që jepet për të gjithë administratën qendrore për muajin dhjetor. Të kalohet paga me listë pagesë, paga kalon në bankë dhe po ashtu shpërblimi, 10 000 lekë, 20 000 lekë, 40 000 lekë... nuk ka rëndësi vlera. Nuk është problemi tek vlera. Kalon po me listë pagesë në llogaritë e çdo punonjësi. Po flasim për punonjësit e deklaruar, ekzistues të partisë. Honoraret janë një gjë tjetër. Edhe honoraret do të duhej për hir të standarteve të kalonin në transaksion bankar, vetëm për të qenë i gjurmueshëm. Është e thjeshtë të tërheqësh para nga arka dhe t'i ndash ato si e mendon më mirë. Por gjendja e arkës si është akumuluar? Ka një provë partia që këtë sasinë e parave që e kaloi nga arka, dikush i autorizuar nga partia, kryetari, kryefinancieri, apo cilido person tjetër, ka shkuar e ka tërhequr në bankë nga llogaria e partisë? E ka derdhur në arkë dhe pasi e ka derdhur në arkë e ka shpërndarë si shpërblime për punonjësit dhe si honorare për të tjerët? Si është akumuluar kjo gjendje e arkës? Nuk ka shkelje jo?! Po flasim për prova! Kjo është pra, gjurmëshmëria e veprimeve financiare, prandaj do të duhet të ndodhë në sistem bankar dhe jo në arka. Kaq! Tatimi është paguar rregullisht, nuk është ky pretendimi.

Z. K. Bele: Çdo shkelje sado e vogël e disiplinës financiare e cila në përputhje me legjislacionin fiskal, mund të konsiderohet si e tillë? Ju thoni që është automatikisht shkelje e ligjit për financimin dhe e kuadrit ligjor që rregullon... pra, e bëni të barazvlefshëm këtë nocion?

Znj. J. Josifi: Po, sepse po flasim për aktivitetin financiar operacional të partisë, sigurisht ky është aktiviteti i përditshëm jashtë periudhës zgjedhore. Marrëdhëniet e punës me punonjësit, vlera në kontabilitet e pasurisë qoftë të paluejtshme, qoftë të luajtshme.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Z. K. Bele: Pra, financieri i partisë kryen një apo dy veprime në harresë, apo në çfarëdolloj veprimesh dhe ju thoni që ka shkel ligjin edhe... më duket se duhet të ketë një... bie dakord me atë të Elvisit. Megjithatë është pak e hollë kjo...

Z. E. Çefa: Zoti Rusmali, pyetje të tjera?

Z. I. Rusmali: Kisha një pyetje për financieren e partisë! Dua të di, partitë politike kontrollohen nga organet tatimore? Organet tatimore vijnë tek ju? Ose ju raportoni para tyre?

Znj. Dh. Isufaj: Ne çojmë bilancin tek organet tatimore, çdo vit. Deri tani nuk na ka ardhur njeri për kontroll.

Z. I. Rusmali: Por, ju nuk e dini nëse kanë të drejtën t'ju kontrollojnë ata, apo jo?

Znj. Dh. Isufaj: Nuk e di!

Z. I. Rusmali: Dakord! Tani për administratën. Do të kthehem edhe unë tek pyetja e kolegut! Pika 1, e nenit 23/4 të ligjit “Për Partitë Politike”, që është bazë ligjore për gjobën që keni vënë ju thotë “Shkelja e dispozitave për financimin e partive politike nga ana e personit përgjegjës, etj..”. Pyetja që kam unë në leximin tuaj, fjalia nënkupton, shkeljen e dispozitave të këtij ligji? Pra, ligjit “Për Partitë Politike” lidhur me financimin, apo shkelje e dispozitave të çdo ligji që është në fuqi në Shqipëri lidhur me financimin? Janë dy opsione. Cili është opsioni që gjykoni ju i referohet kësaj dispozite, kësaj pike të këtij neni?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Znj. J. Josifi: Këtij ligji! Në Kreun III të këtij ligji, mjetet financiare dhe materiale të partive, thuhet se dispozitat e këtij Kreu e pastaj në vijim, rregullojnë financimin e partive politike nga burime financiare dhe materiale publike e jo publike, të cilat nuk rregullohen nga dispozitat e Kodit Zgjedhor, që është ky rast. Pra, aktiviteti vjetor. Pika 2. Financimi i partive politike udhëhiqet nga parimi i transparencës. Të dhënat për burimet financiare dhe shpenzimet e tyre publikohen kurdoherë. Rregullat e monitorimit, mbikqyrjes dhe auditimit të burimeve financiare, materiale, në çdo rast duhet të respektojnë barazinë e partive politike përpara ligjit dhe të mos çenojnë të drejtën e krijimit lirisht të tyre. Që do të thotë nuk mundet të pretendojmë raportim financiar të rregullt dhe transparent nga disa parti dhe të mos kërkojmë zbatimin e rregullave nga disa të tjera. Të thuash se pasuria e paluajtshme, godina e selisë qendrore të partisë e gjendur në mes të kryeqytetit, e në mes të vendit ka vlerën sot, ose në dhjetor të vitit 2022, 1.6 milion lekë, ndjesë, por nuk është korrekte. As në kuptim të këtij ligji, as në kuptim të legjislacionit tjetër tatimor dhe fiskal.

Z. I. Rusmali: Ju na thatë që ka një referencë ligjore të saktë për shkeljen e parë të pretenduar, çështjen e amortizimit, ky është neni 22 i ligjit 8438, që është ligj fiskal?

Znj. J. Josifi: Po!

Z. I. Rusmali: Dakord! Pra, ju për të konstatuar shkeljen, keni ikur nga dispozitat e këtij ligji, tek dispozitat e një ligji fiskal. Baza ligjore e kësaj zhvendosje, cila është? Ky ligj, si ju autorizon ju që të shkoni dhe të konsideroni shkelje mbështetur në dispozitat e një ligji fiskal? U shpreha qartë, apo është konfuze gjëja? Ju thatë që 23/4 ngarkon me përgjegjësi subjektin, në qoftë se subjekti shkel dispozitat e këtij ligji për financimin. Por, shkelja i përket një ligji fiskal. Lidhja si bëhet? Në këtë ligj

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

ku thuhet që shkelja e dispozitave të legjislacionit fiskal për këtë çështje, formon shkelje të dispozitave dhe të këtij ligji?


Z. E. Çefa: Në vijim të kësaj, ligji që prezumohet i shkelur, në vetvehte a përmban sanksione për ato shkelje?

Znj. J. Josifi: Lidhja që ne bëmë me ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat” është për të argumentuar përgjegjësinë e palës e cila do të duhej të kishte respektuar rregullin. Por, rregulli i përgjithshëm që burimet financiare të partisë do të duhet të deklarohen të vërteta dhe me transparencë, qëndron në ligjin “Për Partitë Politike”. Sigurisht që ligji “Për Partitë Politike” nuk është ligji specifik financiar që të përcaktojë rregullat teknike të raportimit financiar. Prandaj nuk mund ta shohim një ligj të shkëputur nga një tjetër, nga gjithë kuadri ligjor në fuqi.

Z. I. Rusmali: Që ne të jemi sistematikë, kjo analiza jonë, mund të na i jepni për të tre, apo katër, sa janë shkeljet, referencën ligjore tek ligji “Për Partitë Politike”? Pra, cila dispozitë e ligjit është shkelur në rastin e amortizimit? Pra, deklarimit gabim të amortizimit. Cila është shkelur në rastin e mos depozitimit të listë pagesave? Cila është shkelur në rastin e mosraportimit të ndarë, cila dispozitë e këtij ligji është shkelur?

Z. L. Braho: Meqenëse po shkel tek dispozita referuese, tani ligji “Për Partitë Politike”, te neni 15/2, pika 2 thotë që: “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bazë dhe për zbatim të ligjit ka këto kompetenca: harton dhe miraton rregullat për raportimin e financimit për monitorimin, mbikqyrjen dhe auditimin financiar të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

partive politike, si dhe për formatet e standartisuara për raportimin financiar vjetor”.
Tani, ky rregulli që është miratuar nga KQZ-ja, a mos e ka ky dispozitën?

Znj. J. Josifi: Ai përcakton formatin e raportimit, është për rastin vjetor...

Z. L. Braho: Formatin është rregulli i fundit, por thotë dhe “rregullat për raportim”.
Mbase këto rregullat për raportim, referojnë te ligji për...

Znj. J. Josifi: Rregullat për raportim në këtë rast, lidhen me formatin në kuptimin e pamjes, por me formatin në kuptimin e përmbajtjes së të dhënave që raportohen në to.

Z. L. Braho: Janë këto, aktive, pasive siç...

Znj. J. Josifi: Patjetër, ka format, por!

Z. L. Braho: Pra janë pjesë?

Znj. J. Josifi: Po!

Z. I. Rusmali: Pyetja ime është, cila dispozitë e akteve nënligjore është shkelur? Për mua është njësoj nuk kam ndonjë kështu... unë dua të di, as të orjentoj, as të të ngatërroj! Dua vetëm të di!

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Znj. J. Josifi: Thjesht për të nxjerr vendimin e Komisionerit “Për miratimin e rregullave...” se është vjetori ky..., por ndërkohë keni nenin 15/2, pika “ç” të ligjit “Për Partitë Politike”.


Z. I. Rusmali: Kjo pastaj është analiza juridike e KAS-it dhe nuk ka nevojë të futemi aty. Gjithësesi, kompetenca e KQZ-së nuk mund të konsiderohet shkelje, se është kompetencë, është e drejtë, është tagër. Referenca te tagri nuk na çon te referencat... duhet dispozita materiale kundër të cilës ke vepruar. Subjekti nuk është se e ka ndaluar KQZ-në që të hartojë dokumentacionin dhe të monitorojë veprimet. Nuk e ka ndaluar! Subjekti mund të ketë bërë eventalisht, mund të ketë bërë, këtë nuk e dimë ende, shkelje të pikës 4, të nenit 23/1. Në raport me kryerjen dhe dokumentimin e shpenzimeve, jo të të ardhurave, të shpenzimeve. Ky është detyrim që i buron nga ky ligj. Dokumentimi i shpenzimeve sipas legjislacionit tatumor në fuqi. Në qoftë se janë shkelur, është shkelur dokumentimi i shpenzimeve sipas këtij legjislacioni, është shkelur dhe një dispozitë e këtij ligji për financimin. E alokoni dot ndonjë nga shkeljet te ky paragraf? Eventalisht, e dini ju këtë gjë!

Znj. J. Josifi: Shkeljen tre dhe katër, pagesat e punonjësve janë shpenzim.

Z. I. Rusmali: Dakord! Mund të na i jepni brenda shqyrtimit, pa e mbyllur shqyrtimin, referencën ligjore tek legjislacioni fiskal, sa i takon listë pagesave për honoraret dhe shpërblimet e Vitit të Ri?

Znj. J. Josifi: Është ligji nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme sigurime shoqërore, shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, neni 11.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Z. I. Rusmali: Ky është për sigurimet shoqërore?

Znj. J. Josifi: Po!

Z. I. Rusmali: Nuk kemi nxitim për këtë!

Znj. J. Josifi: Kemi dhe ligjin nr. 9920/2008 “Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 2, pika “c” dhe “b”. I përgatisim në dosje dhe j’ua sjellim.

Z. I. Rusmali: Dakord! Ne do t’i shqyrtojmë të dyja këto referenca!

Z. E. Çefa: Pyetje të tjera? Nuk ka! Keni diçka tjetër për të shtuar?

Znj. Dh. Isufaj: Meqenëse ju i keni dhënë një detyrë, zonja mundësisht kur të përgatisë materialin ta kemi dhe ne në tavolinë, që edhe të mund të debatojmë se nuk mund të bëhet kështu “kjo çon letër, ne çojmë letër”...

Z. I. Rusmali: Ju lutem, ju mund të përgatiteni vetë për këtë punë, e kuptuat cilat janë pyetjet që kemi ne. Zonja përgatit nga ana e saj përgjigjen dhe ju mund të përgatisni nga juaj përgjigjen. Ju nuk jeni këtu, oponentë e zonjës. Ju jeni për të mbrojtur interesat tuaja. Kërkesa juaj nuk është e mbështetur ligjërisht. Në qoftë se ju e dini kush është lënda, ju deri sa ne të marrim konfirmimin përfundimtar për këtë gjë, mund të punoni, të hapni legjislacionin fiskal dhe të na jepni ju përgjigjen tuaj për këtë çështje.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Znj. Dh. Isufaj: Në rregull, por shoh një tendencë nga zonja...

Z. I. Rusmali: Zonja nuk ka tendencë, siç nuk keni ju tendencë. Zonja është palë në këtë çështje, siç jeni dhe ju palë në këtë çështje. Mbron pozicionin e saj siç mbron ju pozicionin tuaj! Nuk ka tendencë këtu, ka qëndrime të qarta. Tendenca mund të jetë e vakët, është e qartë për ndëshkimin tuaj, sepse po mbron vendimin e Komisionerit. Ju duhet të jeni të qarta për të kundërtën, por duhet të jeni ju të qarta, jo zonja t'ju ndihmojë që të bëheni ju të qarta.

Z. E. Çefa: Tani, dhe një pyetje të fundit për të sqaruar kam unë. Përsëri, referuar pikës 1, nenit 23/4, e cila referon te personi përgjegjës për financat. Pse KQZ-ja ka vendosur të ndëshkojë administrativisht me gjobë subjektin politik dhe jo personin përgjegjës për financat? Ose më mirë me thënë si e argumentoni këtë? Si keni shkuar nga personi përgjegjës tek partia?

Znj. J. Josifi: Pika 1, e nenit 23/4 thotë “shkelja e dispozitave për financimin e partive politike nga ana e personit përgjegjës për financat në parti, apo e personit përgjegjës sipas statutit të partisë”. Nuk thotë se cili është subjekti që gjobitet. Për ne, objekt i këtij ligji është partia politike. Për ne subjekti është partia politike, pavarësisht se ...

Z. I. Rusmali: Të bëj dhe një pyetje të fundit, në qoftë se mund të më ndihmoni. Tek ligji “Për Partitë Politike” ka ndonjë dispozitë që konsideron shkelje, apo si të thuash parregullsitë, difektet në raportim? Te Kodi Zgjedhor, më duket, se ka një shkelje që

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

ka të bëjë me parregullsitë në raportim. Tek ligji “Për Partitë Politike” ekziston kjo shkelje?

Z. E. Çefa: Ndërkohë, përfaqësuesi i Partisë Bindja Demokratike jeni gati të vazhdojmë me ju?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Po!

Z. E. Çefa: Dakord, po i jap fjalën sipas procedurës, përfaqësueses së KQZ, të Komisionerit dhe më pas e keni ju, faleminderit! Zonja Koja për ju fjala, shkurtimisht!

Znj. M. Koja: Referuar auditimit të Partisë Bindja Demokratike, audituesi pretendon se ka komunikuar me financierin e partisë më shumë se një herë, por nuk i është dërguar asnjë informacion dhe si rrjedhojë nuk ka marrë asnjë të dhënë për këtë parti. Në këto kushte Komisioneri ka gjobitur Partinë Bindja Demokratike me gjobë në vlerën 1 000 000 lekë, referuar nenit 23/4, pika 2, të ligjit “Për Partitë Politike”.

Z. K. Bele: Nëse kemi pasur herë tjetër një kauzës të ngjashëm, në një rast, një subjekt thoshte “e kam takuar s’e kam takuar”. Audituesi ka lënë ndonjë provë, ndonjë email? Ka ndonjë rekord që... pa paragjykuar se çfarë do të thotë pala tjetër. Thjesht, ndoshta mund të pretendojë të kundërtën apo jo?

Z. E. Çefa: Fjala për ju, na sqaroni ju lutem!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Në fakt, çështja e Bindjes Demokratike është shumë e thjeshtë, është çështje fakti. Unë pavarësisht se nuk i kam pasur këto prova, madje as arsyetimin e auditimit në një paragraf, përsëri kam bërë në ankimin tim një përmbledhje shumë të vogël, duke thënë që Bindja Demokratike brenda afateve ligjore ka dorëzuar raportin financiar. Kemi qenë në një vështirësi për hartimin e këtij raporti, sepse në këtë moment Bindja Demokratike ka qenë pa një kryetar në detyrë. Për këtë shkak gjatë kësaj periudhe që është bërë dhe auditimi ka qenë pa një kryetar në detyrë, sepse kryetari ka dhënë dorëheqjen paraprakisht dhe kryetari i ri i partisë është emëruar më pas në kohë, pas përfundimit të këtij auditimi. Është çështje e faktit pra, ne e kemi përmbushur të gjithë detyrimet tona, kemi qenë të gatshëm të ofrojmë çdo dokument që kemi në dispozicion për të bërë auditimin. Askush nuk e ka refuzuar bërjen e auditimit. Ligji është shumë i qartë kur thotë që auditimi bëhet nga ana e financierit të partisë. Unë nuk kam qenë asnjë ditë financier i Partisë Bindja Demokratike. Pavarësisht se jam përpjekur në kushtet e mungesës së kryetarit të partisë dhe organeve drejtuese që ta ndihmoj këtë proces sa më shumë që të jetë e mundur. Pretendimi ynë është që ne nuk jemi kontaktuar në mënyrë të rregullt nga ana e audituesit. Financieri apo organet që e kanë pasur për detyrë për të dhënë informacionin e nevojshëm dhe për këtë arsye nuk është dhënë ky informacion. Ne jemi të gatshëm që të gjithë këtë informacion, nëse ka një listë të informatave që duhen për audituesin t'ua japim të gjithë. Ju vemë në vemendje që raporti ynë financiar i vitit 2022, është një raport fare i thjeshtë, pothuaj me të gjitha shifrat "0", për shkak se ne jemi një parti politike që në vitin 2022 nuk kemi kryer fare aktivitet financiar, se as nuk subvecionohemi nga shteti. Vetëm në fushata elektorale kryejmë aktivitet financiar. Dua të them që dokumentat që mungojnë nuk janë shumë të tilla, se nuk e di se çfarë kanë kërkuar audituesi, por nuk mund të jenë shumë se aktiviteti ka qenë shumë i vogël me shpenzime fare minimale. Këtë dua të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

them. Pra, nuk provohet në fakt që organet e partisë janë kontaktuar nga audituesi, organet që e kanë këtë përgjegjësi dhe ata të kenë refuzuar të japin informacionin e kërkuar. Këtu ka vetëm një email, që më është dërguar mua që nuk kam qenë ndonjëherë financiar i partisë, që pretendon që ka disa dokumenta që duhet t'i plotësoja. Unë kam kthyer vetëm një herë përgjigje që them që u vumë në dijeni që ka filluar auditimi dhe nuk kemi asnjë informacion tjetër. Kam në vitin, tetor 2023, bashkëlidhur një email tjetër që thotë "drejtuar kryetarit Astrit Patozi", por që ka ardhur në një adresë tjetër, jo të Astrit Patozit, por të Fabian Topollarit, thotë këtu. Astrit Patozi nuk ka qenë kryetar partie në këtë periudhë. Në gjykimin tonë, jo në gjykimin tonë, por ajo që ka ndodhur është që ne nuk kemi qenë fare në dijeni të nevojës që ka pasur audituesi në këtë rast për t'i çuar dokumentacionet. Po të ishim në dijeni të kësaj nevojë patjetër që do t'ia çonim të gjitha që do tëna kërkonin.

Z. E. Çefa: Zoti Topollari ju i referoheni kësaj shkrese 9 tetor 2023?


Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Jo nuk i referohem kësaj!

Z. E. Çefa: Që i është drejtuar kryetarit Astrit Patozi?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Jo jo, këtë ma vunë tani në dijeni. Në komunikimet e emaleve, del adresa ime që është komunikuar me emaile dhe del fakti që unë kam kthyer njëherë përgjigje që them "kemi marrë dijeni për fillimin e auditimit". Nuk del asgjë tjetër. Tani sapo më vunë në dispozicion një shkresë tjetër që pretendohet që ka qenë bashkëlidhur në email.

Z. E. Çefa: Kjo e datës 9 tetor 2023?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Po, sapo mu vu në dispozicion ku pretendohet se është një shkresë drejtuar zotit Astrit Patozi dhe thotë që “në bazë të kontratës aq e kaq...”.

Z. E. Çefa: Pra, ju kanë kërkuar takim në selinë e partisë! Pra, pyetja ime ishte, e para, a jeni në dijeni me këtë fakt dhe e dyta a është zhvilluar ndonjëherë takim me audituesin e autorizuar ndërmjet lidërshpit të partisë apo financierit të partisë apo nuk e di tani?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Nuk kam dijeni!

Z. E. Çefa: Financier partia a ka?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Në vitin 2022 që është hartuar raporti partia nuk pa pasur financier dhe as kryetar në detyrë, sepse ka dhënë dorëheqjen në shkurt të 2022. Kryetari i ri e ka marrë detyrën shumë më vonë.

Z. E. Çefa: Sipas statutit kush e zëvendëson kryetarin deri ne zgjedhjen e kryetarit të ri?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: E zëvendëson grupi nismëtar i përbërë prej 5 vetësh. Kryetari i partisë sonë është drejtues i grupit nismëtar për sa kohë është drejtues. Në momentin që grupi nismëtar nuk ka një drejtim është i gjithë grupi që luan rolin e kryetarit të partisë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*


Z. L. Braho: Po KQZ-ja ka pasur informacion nga ju që është larguar zoti Patozi në shkurt 2022?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: KQZ-ja ka pasur informacion në zgjedhjet e 2023, ku ne nisëm një procedurë për një kërkesë që në fletën e partisë të regjistrohej tjetër kryetar nga ai që ekzistonte ende në regjistrin e partisë politike. Por një kërkesë që nuk u shqyrtua, sepse është dorëzuar jashtë afateve ankimore në këtë proces.

Z. E. Çefa: Mirë atëherë, dakord. Pyetje të tjera nga kolegë nuk ka. Po administrata...

Znj. J. Josifi: Raportimi financiar vjetor i Partisë Bindja Demokratike është firmosur nga personi përgjegjës për drejtimin e financave, zoti Fabian Topollari. Raportimi financiar dhjetor 2022 dorëzuar me vulën e partisë. Ndërkohë nga argumentimi i tyre pala thotë që në atë periudhë, pra në periudhën e auditimit jo të raportimit nuk ka pasur financier dhe ende nuk ka pasur kryetar partie që mund të mbante marrëdhëniet me të tretët dhe në këtë rast dhe me audituesin. Në informacionin zyrtar që ne i kërkuam audituesit, në janar 2024, përpara se të dilte vendimi i Komisionerit me masat përkatëse, audituesi shprehet me të drejtë, se kontrata për auditimin e raporteve vjetore të vitit 2022 janë lidhur më datë 27.09.2023. Shtator 2023, që do të thotë se pretendimi i Partisë Bindja Demokratike se kryetari në detyrë, zotëria sot e ka marrë këtë detyrë vetëm në qershor 2023, do të thotë që audituesi në shtator ka kontaktuar personin përkatës përgjegjës me të drejtë. I ka dërguar me email, ai i datës 10 tetor, bashkëlidhur kishte dokumentin, shkresën e audituesit të firmosur dhe vulosur nga ai të datës 9 tetor, ku e vë në dijeni për fillimin e procedurave të auditimit. I thotë se bazuar në rregulla do të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

duhet që partia të bashkëpunojë dhe gjendet kjo në paragrafin e dytë ku i thotë: “Ju lutem na konfirmoni marrjen e kërkesës dhe na mundësoni një takim dhe të vijojmë të gjitha çështjet sqaruese sa i takojnë raportit të dorëzuar nga partia të dorëzuar, nga Zoti Topollari dhe të vijonin bashkëpunimin”. Kjo është shkelja e pretenduar. Nuk ka patur bashkëpunim, jo se po të kishte patur bashkëpunim do të ishin gjetur shkelje apo fshehje të të ardhurave e të shpenzimeve. Kjo është arsyeja e masës. Pasqyrën financiare të vitit 2022, besoj duhet ta keni. Është dorëzuar në KQZ në datën 24 mars 2023, me vulën e partisë në çdo faqe, e firmosur nga personi për drejtimin e financave, zoti Fabin Topollari. Faleminderit!


Z. E. Çefa: Ju faleminderit!

Znj. J. Josifi: Dhe diçka! Në emaillet e printuara, në një nga emaillet, zotëria është përgjigjur, që do të thotë ka marrë dijeni për komunikimin. Pra, emailin e ka arritur dhe ai dhe e ka konfirmuar që i ka mbërritur ky informacion.

Z. E. Çefa: Faleminderit. Po zoti Topollari!

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Së pari, unë e sqarova shumë qartë. Ne nuk kemi pasur financier në atë periudhë që është hartuar raporti. Gjithashtu nuk kemi pasur as kryetar partie në detyrë në periudhën që është hartuar raporti. Unë e kam firmosur atë raport në cilësinë e njeriut përgjegjës për komunikimin me KQZ-në, jo në cilësinë e financierit! Unë nuk jam financier, nuk kam qenë kurrë financier i kësaj partie. Kjo parti sa herë ka zgjedhje është e detyruar të përcaktojë financierin dhe nuk jam unë i tillë se nuk kam qenë asnjëherë. Por unë nuk mund të sillja në kushtet kur nuk kisha kryetar partie dhe financier nuk mund të sillja në KQZ një raport pa firmë e vulë. E

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

kam sjellë me firmën e të vetmit njeri që ishte në detyrë, njeriut që mbante raportet me KQZ-në. Tani zonja thotë pse emri yt është atje afër ku shkruhet për drejtimin e financave. Se kështu është formati i KQZ-së dhe unë kam vendosur firmën atje sipas formatit të KQZ-së. Nuk jam unë financieri dhe nuk kam qenë asnjëherë i partisë. Gjithashtu nuk thashë në asnjë moment që në periudhën shtator tetor nuk ka pasur kryetar partie të 2023. Ajo që thashë është që po njihem me këto materialet e emaileve tani. Nga këto materiale rezulton që unë paskam kthyer një përgjigje që e kuptova që filloi periudha e auditimit. Pashë letrat dhe rezultoka që paskam kthyer njëherë një përgjigje. Por, nuk thashë që as është apo jo emaili im ky. Nuk thashë në asnjë moment dhe nuk e di këtë punë a më janë kërkuar ndonjëherë dhe në cilësinë e kryetarit. A më janë vënë në vëmendje që më është kërkuar takim, apo një listë dokumentash që unë duhet t'i plotësoj dhe t'i dërgoja, sepse nuk i kap pasur asnjëherë këto materiale dhe e shpreha që në fillim të kësaj seance që kam pasur vetëm një nen që më thotë që jeni penalizuar se nuk keni bashkëpunuar me audituesin. Ndërkohë që kemi qenë në çdo moment të gatshëm që të bashkëpunojmë. Po të mos ishim të gatshëm nuk dorëzonim raportin. Ne nuk kemi pasur financier, nuk kemi pasur kryetar partie në momentin që kemi dorëzuar raportin dhe e kemi dorëzuar. Pikërisht për të qenë në rregull. Tani në periudhën që kemi pasur financier dhe kryetar partie pse nuk do bashkëpunonim me audituesin? Nuk arrij ta kuptoj!

Z. I. Rusmali: Të lutem zoti Topollari, që ta kuptoj atë që shtjelluat deri tani. Ta kuptoj unë qartë, të mos ngatërrohem. Pretendimi juaj është që përveç emailit të parë të cilin ju keni marrë dijeni dhe keni kthyer përgjigje, emailët vijuese janë të rreme?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Jo, pretendimi im është që unë nuk jam në gjendje të them që këto emaile, përgjigjia që e morëm kërkesën për auditim është apo jo e imja. Ajo që thashë është që më erdhën ca letra..

Z. I. Rusmali: Po thoni që emailin tuaj e shfrytëzojnë persona të tjerë dhe japin përgjigje në emrin tuaj?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Jo, po them që nuk e di fare a është ky emaili im, në bazë të ketyre letrave që më erdhën. Emaili në atë adresë nuk është i juaji? Është i juaji apo jo? A është ky email që keni dhënë ju si kontakt në dokumentacionin e KQZ-së? Në dokumentacionin e KQZ-së për herë të fundit, po në zgjedhjet e vitit 2023.

Z. I. Rusmali: Do me thënë në tetor 2023 ka qenë ky email? Të gjitha emaillet janë dërguar në të njëjtën adresë? Dakord të gjitha në të njëjtën adresë! Keni pretendim që ndonjë prej tyre është i falsifikuar? Mos kemi manipulim dokumentash?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Zoti Rusmali nuk po kuptohemi. Ky është emaili im që e kam dërguar për zgjedhjet e Prill 2023 dhe vetëm për ato zgjedhje. Nuk e di a e kam pasur aktiv këtë email në vijimësi. Duhet gjithashtu ta verifikoj edhe këtë gjë. Ajo që ju thashë është që nga këto emaile rezulton që kam kthyer njëherë përgjigje. Kam nevojë ta vërtetoj këtë punë se e kam të pamundur ta them sot. Por gjithashtu ve në vemendje që unë nuk kam qenë asnjëherë financier i partisë. Në atë moment jo e jo njëhere se kam qenë kryetar i partisë dhe nuk mund të isha financier.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

Z. I. Rusmali: Ju mund ta vini në vemendje këtë është e drejta juaj, por ajo që është e rëndësishme për KAS-in, besoj për të gjithë kolegët jemi në një mendje. Ne duhet të vërtetojmë nëse subjekti ka marrë dijeni për komunikimin apo jo. Subjektit i komunikohet njoftimi ose vendimarrja nëpërmjet personave se subjekti është subjekt. Nëse ju thoni që ju nuk keni lidhje përgjegjësie me subjektin, duhet të na shtjelloni keni apo jo? Do me thënë në tetor të vitit 2023 kishit, apo jo lidhje përgjegjësie me subjektin? Kaq është debati këtu. Nëse ju në tetor të vitit 2023 keni qenë person me përgjegjësi të subjekti, për ne do të thotë që subjekti ka marrë dijeni për fillimin e auditimit.

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Ajo që po them është që unë u njoha me këto dokumenta tani dhe po e përsëris, ndoshta nuk jam shumë i aftë të jap përgjigje ezauroese për çdo element se sa u njoha. E vura në vemendje që në fillim të këtij procesi këtë gjë, që nuk jam njohur me asnje dokumentacion. Nga kjo që u njoha unë vetëm në një moment kam kthyer një përgjigje që them, po “morëm emailin tuaj informues për fillimin e auditimit” dhe nuk di fare nëse më është kërkuar më në të ardhmen të çoj dokumenta. Nëse më është kërkuar ta lidh me financierin dhe çdo gjë tjetër.

Z. I. Rusmali: Është shumë e qartë ju mund të merrni kohën tuaj. Merrni kohën tuaj për ta kthjelluar gjënë edhe për të qartësuar komunikimin edhe përgjegjësitë e të gjitha me rradhë. Shtegu që ne nuk e ndjekim dot është shtegu që partia politike çlirohet nga detyrimet ligjore nëse ka një hall brenda vetes. Nëse i mungon kryetari, ose nëse i ka ikur financieri. Detyrimet janë detyrime që janë të subjektit, për disiplinën e marrëdhënieve jepen emrat, por emrat janë irrelevant ne raport me

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 4.06.2024*

detyrimet. Kjo është ligjore. Këtë analizë po të doni ne e bëjme, por nuk ecim dot, është shteg që të çon asgjekundi.

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Jam shumë i qartë.

Z. I. Rusmali: Për pjesën tjetër a i ke marrë komunikimet, a ka marrë dijëni subjekti, e kështu me rradhë, a ka pasur vullnetin apo jo? Ka pasur forcë madhore apo s'ka pasur, kjo është çështje e juaj. Ju do e shtjelloni dhe do të na bindni për këto. Por, debate në shtigje që çojnë asgjekundi nuk ka nevojë të bëjmë, se harxhojmë kohën kot, harxhojmë kohën e njëri tjetrit.

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: I nderuar, ajo që thashë unë është që gjatë periudhës së hartimit të raportit kemi qenë në vështirësi dhe prapë e kemi zbatuar këtë detyrim ligjor për shkak të mungesës së njerëzve. Këtë thashë. Nuk thashë asgjë tjetër që ne nuk mbajmë përgjegjësi se nuk kemi pasur organe drejtuese në atë periudhë. Në periudhën e hartimit të raportit po ne e kemi përmbushur atë detyrim.

Z. I. Rusmali: Keni qenë të vetdijshëm për detyrimin ligjor?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Po dhe e kemi përmbushur dhe e kemi bërë raportin në kohë.

Z. I. Rusmali: E gjithë historia është në tetor të vitit 2023, ishit të vetdijshëm për detyrimin ligjor apo jo?

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 4.06.2024


Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Po dhe atë jam duke thënë. Në tetor të vitit 2023 ka vetëm një komunikim nga kryetari i partisë dhe jo nga financieri që thotë e morëm dijeninë për vazhdimin e auditimit. Ekam dorëzuar raportin dhe kam pasur financiar në atë moment. Tani kam thënë vetëm e morëm dijeninë për fillimin e auditimit. Tani më thoni çfarë nuk kam bërë mirë pasi mora dijeni për fillimin e auditimit, që të...

Z. I. Rusmali: Pretendimi i KQZ-së është që nuk keni bashkëpunuar në vijimësi me audituesin që është detyrim ligjor për të bashkëpunuar.

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Kemi bashkëpunuar, sepse nëse audituesi do të na kërkonte takim apo do të na bënte listë dokumentash që duhet t'ia jepnim, t'ia dërgonte organit kompetent, në këtë rast kryetarit apo financiarit, ne do t'ia kishim vënë këto dokumenta në dispozicion.

Z. I. Rusmali: Audituesi të gjitha kërkesat i ka bërë në të njëjtën adresë, në të cilën ju morët dijeni për fillimin e procesit. Në të njëjtën adresë, në të njëjtën ditë, në të njëjtën formë me të cilën ju morët dijeni për fillimin e procesit. Nga momenti që ka filluar procesi ju keni absolutisht detyrime konkrete për të zbatuar. Se njoftimi nuk ju bëhet që ju të jeni në dijeni. Ju bëhet që ju të zbatoni detyrimet tuaja. Tani na thoni a keni pasur pengesa të ligjshme për pjesën në vijim, por mos na thoni nuk kam lexuar emailt se kjo është e juaja. Nuk është as e audituesit as e KQZ-së. Marrja në dijeni është e mjaftueshme për KQZ-në, për të mos ju çliruar apriori nga detyrimi. Nëse ju nuk do të merrnit dijeni dot, atëherë përgjegjësia për t'iu vënë në dijeni do të ishte e KQZ-së dhe KQZ-ja duhet ti dilte zot kësaj përgjegjësie. Por, hapin e parë KQZ-ja e ka bërë, ju ka vënë në dijeni për fillimin e procesit, gjithshka që vjen pas

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 4.06.2024

janë detyrimet tuaja. Ju duhet të kontaktonit medoemos me audituesin. Ju duhet t'i krijoni lehtësira audituesit. Ju duhet ta ftonit audituesin në selinë tuaj që ai të mund të shihte dokumentacionin. Janë tuajat të gjitha. Audituesi provon nga ana e tij që ai ka bërë përpjekjet e nevojshme për ta çuar përpara komunikimin. Ka bërë listën me kërkesat e tij, ju ka vënë afat dhe ju ka paralajmëruar për pasojat ligjore që vijnë nga mosrespektimi i afateve. Tani ju thoni unë nuk mbaj mend, nuk jam i sigurt nëse i kam lexuar ndonjëherë. Unë nuk di të them nëse janë në emailin tim këto gjëra apo jo?

Z. F. Topollari, përfaqësues i BD: Po, sepse sapo u njoha me këto akte, prandaj!

Z. I. Rusmali: Provoni të kundërtën, por duhet ta provoni ju.

Z. E. Çefa: Unë besoj që problematikat dolën dhe u ezauruan. Tani nuk po kalojmë në fazën e konkluzioneve përfundimtare për shkak se po e lemë të dëgjojmë dhe ankimuesin e tretë dhe më pas të konkludojmë në seancën tjetër. Kështu që ne do ta ndërpresim këtu këtë seancë për ta rimarrë, për ta rifilluar në datën 11 qershor 2024, ditën e martë në orën 11:00. Dakord? Me kaq e deklarojmë të mbyllur këtë seancë. Ju falenderojmë të gjithëve!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*